



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

---

Prishtinë, datë 10.09.2019

- *Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale* -

**REALIZIMI I PLANIT PËR VIZITA NË ZONA  
EKONOMIKE**

*Shtator 2019*

## Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në shtojcën 21 të Rregullores (QRK) 16/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ka në mandat që në koordinim me MTI-në e përkrah zhvillimin e Zonave Ekonomike.

Me qëllim të përmbushjes së mandatit të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe realizimit të Planit të Punës për vitin 2019, në muajin Maj dhe Qershor, MZHR dhe MTI realizuan dy (2) takime. Njëra prej përfundimeve të këtyre takimeve, ishte dhe realizimi i vizitave të përbashkëta n zona ekonomike.

Gjatë muajit Gusht 2019, MZHR në koordinim me MTI-në kanë përgatitur Planin për realizimin e vizitave në zonat ekonomike ku ka biznese funksionale. Zonat ekonomike të vendosura në Plan ishin: Parku i Biznesit Drenas, Parku i Biznesit në Mitrovicë, Parku Teknologjik në Shtime, si dhe Zona Industriale në Shirokë-Suharekë. Qëllimi i realizimit të këtyre vizitave ishte të identifikojë nevojat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen bizneset në kuadër të zonave ekonomike, si dhe konform mandatit që ka të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, të identifikojë dhe zhvilloj politika dhe programe për përkrahje të zonave ekonomike në vitet në vijim.

Me dakordimin e palëve, u përgatit edhe një Plan operativ i ndarjes së detyrave ku MTI morri në përgjegjësi njoftimin e zonave për vizita dhe shoqërimin e MZHR-së gjatë vizitave. Ndërsa MZHR përgatiti pyetësin, caktojë ekipin, dhe morri përsipër transportin.

Vizitat u realizuan nga datë 02 deri 05 Shtator 2019 dhe u plotësuan rreth 45 pyetësorë me pyetje dhe përgjigje që ndërlidhen me ambientin e të bërit biznes në kuadër t zonave ekonomike.


## Vizita në Zonën Ekonomike “Parku i Biznesit në Drenas”

Vizita e parë u realizua me datë 02.09.2019 në Zonën Ekonomike “Parku I Biznesit në Drenas”. Vizitën e realizojë një grup i përbashkët MZHR - MTI, të cilët vizituan rreth 15 biznese që funksionojnë në kuadër të zonës. Temat e diskutuara ndërmjet ekipit dhe përfaqësuesve të bizneseve, ndërlidheshin me kushtet e të bërit biznes brenda zonës, kapacitetet ekzistuese të bizneseve, evidentimi i nevojave për përkrahje institucionale, etj. Ndër të tjera, në kuadër të kësaj vizite u plotësuan 15 pyetësor me pyetje dhe përgjigje që ndërlidhen me fushën e të bërit biznes.

Nga konsultimet e realizuara me biznese të kësaj zone, kuptuam se:

- Katër kompani eksportojnë brenda vendit, veprimtaria e tyre është: Prodhim I gurit dhe përpunim I drurit, Prodhim i produkteve higjienike, Prodhim I brisqeve të makinerive për zdrukthuari, mobilie, Prodhim I mobilieve, dritareve plastike dhe kuzhinave.
- Një kompani importon( Shqipëri), veprimtaria e saj është tregti me shumicë).

Në vijim paraqiten edhe disa foto të realizuara gjatë vizitave të bizneseve të kësaj zone.



## Vizita në Zonën Ekonomike "Parku i biznesit Mitrovicë"

Vizita e dytë e paraparë me Planin e vizitave në zona ekonomike, ishte vizita në Zonën Ekonomike "Parku i biznesit Mitrovicë". Kjo vizitë u realizua me datë 03.09.2019. Gjatë kësaj vizite, përfaqësuesit e MZHR-së takuan rreth 15 përfaqësues të bizneseve që funksionojnë në kuadër të zonës, diskutuan lidhur me vështirësitë dhe mangësitë e funksionimit, si dhe identifikuan nevojat që kanë bizneset për përkrahje nga institucionet në të ardhmen. Me këtë rast, përfaqësuesit e MZHR-së dhe bizneseve të vizuara, plotësuan 10 pyetësorë me pyetje dhe përgjigje që ndërlidhen me ambientin e të bërit biznes.

Nga konsultimet e realizuara me biznese të kësaj zone, kuptuam se:

- Tri (3) kompani eksportojnë jashtë vendit (Zvicër, Maqedoni, Shqipëri, Slloveni, Itali, Kroaci). Veprimtaria e këtyre bizneseve është: Termo izolime, Riciklim dhe Shtypje të materialeve, dokumenteve.
- Një (1) kompani importon jashtë vendit ( Gjermani, Turqi), produkte farmaceutike.
- Gjashtë (6) kompani eksportojnë brenda Kosovës, veprimtaria e tyre është: Prodhim i tullave, Prodhim i ëmbëlsirave, Ushqim (distribuim), Prodhim i qeseve të mbeturinave dhe qeseve të frizit, Sanitari, Dyer të metaleve.

Në vijim paraqiten edhe disa foto të realizuara gjatë vizitave të bizneseve të kësaj zone.



## Vizita në Zonën Ekonomike "Parku Teknologjik në Shtime"

Vizita në Zonën Ekonomike "Parku Teknologjik në Shtime", u realizua më datë 04.09.2019. Numri i bizneseve që funksiononin në kuadër të kësaj zone ishte rreth 10 biznese. Një numër i tyre ishte jo funksionale. Mirëpo, pavarësisht kësaj, përfaqësuesit e MZHR-së takuan bizneset funksionale në kuadër të zonës dhe përveç bisedave dhe konsultave që ndërlidhen me kushtet e të bërit biznes, plotësuan edhe 3 pyetësor.

Nga konsultimet e realizuara me biznese të kësaj zone, kuptuam se :

- Dy (2) kompani eksportojnë brenda Kosovës, veprimtaria e tyre është: Prodhim I shtyllave të betonit, shtyllave elektrike dhe Prodhim i karrikave të drurit dhe të metalit.

Në vijim paraqiten edhe disa foto të realizuara gjatë vizitave të bizneseve të kësaj zone.






## Vizita në Zonën Ekonomike “Parku Industrial në Shirokë - Suharekë”

Në përmbyllje të Planit për vizita në zona ekonomike, përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me datë 05.09.2019 vizituan Zonën Ekonomike “Parku Industrial në Shirokë – Suharekë. Në kuadër të kësaj zone, ishte një numër i konsiderueshëm i bizneseve funksionale dhe me këtë rast përfaqësuesit e MZHR-së dhe të atyre bizneseve, diskutuan në përgjithësi lidhur me vështirësitë dhe mangësitë e funksionimit të tyre në kuadër të zonës, si dhe nevojat që kanë si biznese për përkrahje nga institucionet në të ardhmen. Nga 18 biznese të vizituara janë plotësuar gjithsej 15 pyetësor.

Nga konsultimet e realizuara me biznese të kësaj zone, kuptuam se :

- Shtatë (7) kompani eksportojnë jashtë vendit (Zvicër, Gjermani, Itali, Maqedoni, Mali Zi, Shqipëri, Serbi), veprimtari e këtyre bizneseve është: Enterier I brendshëm, Përpunim I lëndëve djegëse, Prodhim I rrjetave të betonit, llaqeve, fasadës, polisterolit, dritare, roleta alumini dhe ngjyrave.
- Dy (2) kompani importojnë ( Shqipëri, Maqedoni, Gjermani), veprimtaria e tyre është: Tregëti e lëndëve djegëse-gazit, laminat dhe parket.
- Shtatë (7) kompani eksportojnë produkte brenda vendit, veprimtaria e tyre është: Prodhim i elementeve të betonit, Prodhimi mobilieve, fasadave, ngjyrave, roletave të aluminit dhe gurit dekorativ.

Në vijim paraqiten edhe disa foto të realizuara gjatë vizitave të bizneseve të kësaj zone.



## Përfundime

Pas përfundimit të këtij aktiviteti “Realizimi i vizitave në Zona Ekonomike në Kosovë”, si dhe analizimit të diskutimeve dhe konsultave të realizuara me përfaqësues të bizneseve, arrijmë tek përfundimet si vijon:

1. Bizneset në zona ekonomike kanë një infrastrukturë të mirë për zhvillim të biznesit;
2. Një numër i konsiderueshëm i bizneseve janë në prodhim, të përkushtuara dhe me vizion për rritjen e kapaciteteve me qëllim të rritjes së eksportit;
3. Një numër i madh i bizneseve kanë paraqitur nevojën për ngritje të kapaciteteve përmes pjesëmarrjes në seminare, konferenca dhe panaire që organizohen në Kosovë dhe jashtë saj;
4. Një numër i ulët i bizneseve që funksionojnë në kuadër të zonave, kanë përfituar grante nga shteti;
5. Të dhënat e siguruar nga vizitat, do të shërbejnë për përgatitjen e një analize nga MZHR, lidhur me funksionimin e tyre dhe si dhe identifikuan nevojat që kanë këto biznese për përkrahje në të ardhmen.
6. MZHR të marrë për bazë të dhënat e siguruar nga ky aktivitet, në kontekst të zhvillimit të programeve të veçanta në vitet në vijim, për përkrahje të bizneseve që janë në kuadër të këtyre zonave.